



PËRSHKRIMI

Organizata YMCA MOVEMENT- YMCA LËVIZJE shpall konkurs për pozitën: **Zyrtar/e të Financave**.

Rreth organizatës:

YMCA MOVEMENT në Kosovë është një organizatë e bazuar në vlerat e vullnetarizmit që për qëllim ka inspirimin dhe inkurajimin e lidershit tek të rinjtë dhe të rejtat. Asiston në një ambient të shëndetshëm të komunitetit. YMCA Movement është anëtare me të drejta të plota në Federatën YMCA Evropës dhe në Federatën Botërore të YMCA-së ku dhe përfaqëson Republikën e Kosovës. Është organizata e parë e të rinjëve në botë e themeluar në vitin 1844 në Londër, Angli. Aktualisht YMCA në Kosovë operon në 12 lokacione të ndryshme duke ofruar aktivitete për rini dhe komunitetin.

Lokacioni: Gjakovë

Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi me orarë të plotë.

Përgjegjësitë kryesore:

- Të ndjek dhe të kuptojë me kujdes kontratat, projektet, buxhetet dhe udhëzimet e donatorëve dhe të monitorojë shpenzimet sipas linjave buxhetore,
- Pranon dhe i kontrollon faturat e rregullta sipas projekteve,
- Përgatitja e raporteve financiare sipas projekteve të përcaktuara,
- Të përgatisë dokumente mbështetëse financiare dhe administrative të përcaktuara nga politika e brendshme dhe rregulloret financiare,
- Përgatitja e kontratave të stafit me dokumentet mbështetëse,
- Mirëmbajtja e arkës,
- Përgatitja e pjesës administrative të projekteve dhe arkivimi.
- Punon drejt për drejtë me Menaxherët e projekteve,
- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe organizative sipas nevojës.
- Angazhohet dhe ndihmon dhe në programet tjera të organizatës kur është e nevojshme dhe kërkohet,
- Të punojë në bazë të misionit dhe vizionit të organizatës dhe gjithmonë t'i jep përparësi nevojave të komunitetit pasi puna jonë mbështetet në ndihmën e të tjerëve dhe fuqizimin e të rinjëve dhe të rejtave,
- Ndhmon organizatën në implementimin e strategjisë aktuale të organizatës "Y for All",

Kriteret e Përgjithshme:

- Kualifikim universitar me drejtim ekonomik,
- Preferohet më së paku dy vitë përvojë në punë në financa,
- Preferohet të kenë trajnime dhe certifikime në këtë lëmi,
- Preferohet njohuri të mira të gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar,
- Shkathtësi të mira kompjuterike,
- Të jetë person i/e besueshëm dhe me etik pune të fuqishme,
- Aftësi të mira organizimi, komunikimi dhe për të punuar në grup,
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur.

Si të aplikoni: Ata/ato që janë të interesuar/a ju lutem dergoni një CV dhe letër motivuese në email adresën:

office@ymcacosovo.com.

Në subjekt të email-it ju lutem shkruani pozitën për të cilën po aplikoni.

Aplikacionet pranohen deri me datën 26.09.2024, gjitha aplikacionet që dërgohen pas kësaj date nuk do të mirren parasysh.

Vetëm kandidatët prej listës së ngushtë do të kontaktohen për intervistë.